

VENDIM
Nr. 173, datë 18.3.2022

**PËR DHËNIEN E MBROJTJES SË PËRKOHSHME SHTETASVE UKRAINAS,
PERSONAVE PA SHTETËSI DHE PERSONAVE QË KANË FITUAR MBROJTJE
NDËRKOMBËTARE NË UKRAINË, ME VENDQËNDRIM TË PËRKOHSHËM
OSE TË PËRHERSHËM NË UKRAINË, SI DHE PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS
PËR MENAXHIMIN E FLUKSIT TË KËRKUESVE TË MBROJTJES
NDËRKOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 82, të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e mbrojtjes së përkohshme shtetasve me shtetësi ukrainase, personave pa shtetësi dhe personave që kanë fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare në Ukrainë, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Ukrainë, që hyjnë masivisht në territorin e Republikës së Shqipërisë për arsye të luftës, cenimit të jetës së civilëve të pambrojtur, përshkallëzimit të veprimeve të armatosura ndaj popullsisë civile, që kërkojnë mbrojtje nga Republika e Shqipërisë.

2. Mbrojtja e përkohshme jepet edhe për ata shtetas ukrainas apo persona pa shtetësi dhe persona që kanë fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare në Ukrainë, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Ukrainë, të cilët kanë hyrë dhe po qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për shkaqet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Mbrojtja e përkohshme për këta shtetas fillon nga momenti i hyrjes në Republikën e Shqipërisë për një afat 1-vjeçar.

4. Përjashtohen nga e drejta e mbrojtjes së përkohshme të gjithë personat të cilët plotësojnë një nga kushtet e përcaktuara në nenin 83, të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

5. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të vendosë që kërkuesit t’i kufizohet liria e lëvizjes, nëse e konsideron të nevojshme, bazuar në vlerësimin individual të secilit rast, sipas përcaktimeve të neneve 46 e 47, të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

6. Krijimin e Task-Forcës, si një strukturë e posaçme e përkohshme me afat 1-vjeçar, për menaxhimin e fluksit të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare nga shtetasit e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

7. Task-Forca kryesohet nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe në përbërje ka këta anëtarë:

- Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Ministrin e Mbrojtjes;
- Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministrin e Arsimit dhe Sportit;
- Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministrin e Drejtësisë.

7.1. Sipas nevojave, ftohen të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve të tjera, me kërkesë të drejtuesit të Task-Forcës.

7.2. Kur për shkaqe të arsyeshme, ministri drejtues apo ministri anëtar nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, atëherë në vend të tij merr pjesë, përkatësisht, zëvendësministri, përfaqësues i ministrit në mungesë ose një përfaqësues i nivelit të lartë drejtues, i autorizuar prej tij.

8. Task-Forca e përmendur në pikën 7, të këtij vendimi, ka këto detyra:
- a) Negocion me partnerët ndërkombëtarë për çështjet që lidhen me objektin e këtij vendimi;
 - b) Harton planin e veprimit për menaxhimin e fluksit të kërkesve të mbrojtjes ndërkombëtare, përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi;
 - c) Koordinon situatën e pritjes dhe akomodimit të shtetasve, përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi;
 - ç) Evidenton nevojat emergjente për t'i paraprirë punës me ndryshimet e mundshme të kuadrit ligjor, nënligjor e rregullator, të cilat ndikojnë në përmirësimin në këtë funksion;
 - d) Analizon kërkesat shtesë buxhetore për funksionimin, shpenzimet dhe bazën e nevojshme materiale, si dhe koordinon fondet e donatorëve për këtë qëllim;
 - dh) Koordinon punën për marrjen e masave për arsimimin e përkohshëm dhe mbështetjen psikosociale të fëmijëve që i përkasin moshës së arsimit parauniversitar, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
9. Sekretariati teknik i Task-Forcës është drejtoria përgjegjëse për azilin, pranë Ministrisë së Brendshme.
10. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama